



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2022

### V E N D I M

**Nr. 63, datë 29/03/2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 185, datë 12.10.2021, e z. A.N., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile” dhe “gjendjes shëndetësore” nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e tij, z. A.N., i datëlindjes 23.02.1974, banues në Njësinë Administrative Topojë, Fier, sqaron se është kryefamiljar i vetëm, me status jetimi, i papunë dhe është i diagnostikuar me Tumor Testi<sup>3</sup>. Ankuesi sqaron se ka aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk është përzgjedhur për ta përfituar këtë ndihmë. Ai shprehet se nuk ka asnjë të ardhur tjetër dhe nuk mundet të përballojë jetesën, aq më tepër në kushtet e sëmundjes, nga e cila vuan.

Nëpërmjet shkresës nr.9316 prot., datë 08.10.2021, së Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Bashkisë Fier, z. A.N. është sqaruar se ai është refuzuar nga Sistemi i Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike me motivacionin “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”, si dhe bëhet me dije se

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>3</sup> Referuar epikrizës përcjellëse të lëshuar nga Spitali Rajonal Fier, në datën 21.09.2021, Fletës së Biopsisë me Nr. 726-737 etj.

indikatorët e vlerësimit nuk i menaxhon Bashkia, por Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier, të cilat janë institucionet që marrin vendime.

Pretendimi tjetër që ka ankuesi konsiston në faktin se pavarësisht se nuk ka qenë kurrë përfitues i ndihmës ekonomike, fakt që vërtetohet nëpërmjet shkresës nr.132 prot., datë 21.09.2021, të Drejtorisë së Shërbimit Social, pranë Bashkisë Fier, ai shprehet se në kartën e tij të shëndetit figuron përfitues i kësaj ndihme. Ai ka depozituar në cilësi prove pranë KMD, kopje të kartës së shëndetit, si dhe kopje të vlerësimit të tij nga Sistemi i Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike, ku rezulton se *“Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”*.

Ankuesi kërkon sqarimin e çështjes së sipërcituar, si dhe kërkon ndërhyrjen e Komisionerit me qëllim përfitimin e ndihmës ekonomike (përkrahjes sociale), në bazë të Ligjit nr.121/2016 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”* dhe Vendimit nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile”* dhe *“gjendjes shëndetësore”* duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij

ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 185, datë 12.10.2021, e z. A.N., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë Rajonale të

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

Shërbimit Social Shtetëror Fier, si dhe për dijeni ankuesit dhe Bashkisë Fier, me shkresën nr. 1432/1, datë 18.10.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
  2. Informacion lidhur me indikatorët e vlerësimit të Sistemit të Menaxhimit të Ndhmës Ekonomike dhe mënyrës së si kryhet përzgjedhja përkatëse;
  3. Informacion nëse ankuesi i plotëson kriteret përkatëse, për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike (përkrahjes sociale) të dhënë nga shërbimi social shtetëror;
  4. Kryerja e verifikimeve në lidhje me pretendimin e ankuesit se rezulton përfitues i ndihmës ekonomike, sipas të dhënave të shënuara në kartën e tij të shëndetit;
  5. Informacion nëse ankuesi ka depozituar ankesë pranë institucioneve tuaja, lidhur me çështjet që janë objekt ankese;
- Në përgjigje të shkresës nr. 1432/1, datë 18.10.2021, së KMD-së, Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar shkresën nr. 1883/1 prot., datë 27.10.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se mbështetur në verifikimin e kryer në Regjistrin Elektronik Kombëtar rezulton se ankuesi ka patur 3 (tre) aplikime në skemën e ndihmës ekonomike përkatësisht në muajin tetor 2019, tetor 2020 dhe mars 2021. Në të treja këto aplikime në skemën e ndihmës ekonomike, z. A.N. nuk ka rezultuar përfitues, pasi është refuzuar nga sistemi me arsyen *“nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”*. Mbështetur në Kreun IV, pika 2, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 *“Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*, për ato familje që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, është Këshilli Bashkiak, ai që ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për to, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë për ndihmën ekonomike.

Nga verifikimet e kryera në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë Rajonale Fier dhe administratorin shoqëror të njësisë Topojë rezulton se z. A.N. ka përfituar ndihmë financiare prej 16 000 lekë sipas pikës 1, të VKM-së nr. 13, datë 22.04.2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 305, datë 16.04.2020, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”* ku parashikohet: *“Dhënien e ndihmës financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar bashkive, përveç rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit*

15 të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, e vërtetuar kjo nga listëpagesa bashkëlidhur e Njesisë Administrative Topojë.

Shërbimi Social Shtetëror sqaron se lidhur me problemet shëndetësore dhe ekonomike të ankuesit, administratori shoqëror i njesisë Topojë e ka informuar dhe orientuar z. A.N. për të parë mundësinë e aplikimit për përfitim nga skema e aftësisë së kufizuar (KEMP), e cila është një procedurë e ndarë nga ndihma ekonomike dhe kryhet sipas kritereve të përcaktuara në VKM-në nr. 182, datë 26.02.2020 “Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës sociale”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se rezultojnë përfitues i ndihmës ekonomike sipas të dhënave të shënuara në kartën e tij të shëndetit, sqarohet se karta e shëndetit është dokument dhe lëshimi apo administrimi i saj nuk është kompetencë e Shërbimit Social Shtetëror. Lidhur me kriteret për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike, si dhe mënyrën se si kryhet përzgjedhja përkatëse, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019, neni 7, germa a), si dhe VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2, germa a) përcaktohet se: “...përfituesit e ndihmës ekonomike janë...(a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.”

Familjet që nuk kanë të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitanca, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, si dhe individët mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, nga datat 1-10 të çdo muaji pranë njesisë vendore/bashkisë ku kanë vendbanimin. Administratori, në prani të kryefamiljarit/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en ose të vetëm, kur nuk ka të tillë, plotëson në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike, i cili përmbledh informacione për demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin, llojin e banesës, pasuritë/asetet shtëpiake, të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale etj. Pasi përfundon aplikimi në sistem, si dhe pasi kryhen verifikimet përkatëse, vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit të aplikimit të qytetarëve nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, nëpërmjet zbatimit të formulës së unifikuar të përcaktuar në VKM-në e sipërcituar, Kreu II, pika 8 (b). Formula e unifikuar e pikëzimit është formulë e pranueshmërisë së individëve/familjeve për ndihmë ekonomike, e cila përdor koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të lidhura me statusin ekonomik dhe varfërinë si dhe përfshin parametra për vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve të tilla, si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale, remitanca, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoaria, trashëgimia dhe dhuratat të përcaktuara në VKM-në nr. 956, datë 07.12.2016. pra, përzgjedhja e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo refuzimi i tyre kryhet nga DRSHSSH përmes sistemit

elektronik, bazuar në formulën e unifikuar të pikëzimit, e cila vlerëson deklaratimet e bëra nga qytetari në formularin fillestar të aplikimit.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale nuk kanë kompetencë në përcaktimin e indikatorëve apo kriterëve të përdorura për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe e informon KMD-në mbi faktin se z. A.N. nuk ka depozituar asnjë ankesë pranë këtij institucioni, lidhur me çështjet objekt ankese.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se ky institucion e bazon veprimtarinë e tij në zbatim të legjislacionit në fuqi. Në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019, neni 2, germa a) përcaktohet se ky ligj ka për qëllim: *“të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore për shkak të aftësisë dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore”*. Bazuar në qëllimin e ligjit të sipërcituar si dhe në procedurën e ndjekur për aplikim në skemën e ndihmës ekonomike, z. A.N. nuk është i diskriminuar, pasi ndaj tij nuk janë ndërmarrë veprime që mund ta kenë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm. Ky institucion thekson faktin se është pikërisht gjendja e tij e vështirë, ekonomike, ajo që i jep të drejtën për të gëzuar mbrojtje nga legjislacioni i ndihmës ekonomike dhe jo të ketë shërbyer si burim diskriminimi.

- Në përgjigje të shkresës nr. 1432/1, datë 18.10.2021, së KMD-së, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier ka dërguar shkresën nr. 317/1prot., datë 26.10.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se nga verifikimet e kryera në Sistemin elektronik të ndihmës ekonomike dhe nga komunikimi me administratorin Social të Njësisë Topojë, ku z. A.N., ka vendbanimin rezulton se ankuesi ka aplikuar për të përfituar ndihmë ekonomike në sistemin elektronik në datën 08.10.2019, në datën 09.10.2020 dhe në datën 01.03.2021 dhe në të tre rastet ka rezultuar nga sistemi i pikëzimit me pikë të pamjaftueshme. Përllogaritja bëhet nga sistemi elektronik në bazë të një formule të unifikuar bazuar në deklaratimet e bëra në aplikimin fillestar të qytetarit, ku i parashtrihen pyetjet sipas formularit të miratuar me VKM nr. 597/2019.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Fier nuk përcakton indikatorët dhe kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike, por ato përzgjidhen nga sistemi elektronik.

Z. A.N. ka përfituar nga dhënia e ndihmës financiare prej 16 000 lekësh sipas VKM nr 13, datë 22.04.2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 305, datë 16.04.2020 “për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”*.



Duke qenë se ankuesi ka qenë aplikues në sistemin elektronik, ai ka përfituar këtë masë vërtetuar nga listëpagesa e njësisë administrative Topojë. Për sa i përket kartës së shëndetit, ky është një dokumentacion që nuk lëshohet nga institucioni i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier.

Lidhur me problemet shëndetësore, për të cilat ka pretendime z. A.N., ai është orientuar nga administratori shoqëror i njësisë administrative, ku ka vendbanimin për të marrë dokumentacionin e nevojshëm për të parë mundësinë e aplikimit për KEMP, e cila është një procedurë e ndarë nga ndihma ekonomike. Gjithashtu, administratori social është orientuar ta udhëzojë ankuesin të riaplikojë në sistemin elektronik, si dhe të shihet mundësia e trajtimit me fondin 6%.

- Në vijim, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 11.01.2022, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqitën znj. G.M. përfaqësuese e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier dhe znj. D. M, përfaqësuese e Shërbimit Social Shtetëror. Ankuesi A.N. nuk u paraqit në seancë dëgjimore. Përfaqësuesit e KMD-së parashtuan pretendimet e ankuesit, për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile.

Përfaqësuesja e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier u shpreh se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë ankese pranë këtij institucioni. Mbi çështjen e tij, ky institucion ka marrë dijeni nga korrespondenca zyrtare e KMD-së dhe në vijim nga administratori i njësisë administrative, ku banon ankuesi. Ajo u shpreh se z. A.N. ka aplikuar për ndihmë ekonomike, por ka rezultuar se nuk ka patur pikët e mjaftueshme. Sistemi elektronik i ndihmës ekonomike i përzgjedh automatikisht personat që janë përfitues të ndihmës ekonomike. Në këto kushte, nuk mund të ketë diskriminim. Ajo u shpreh se është në dijeni të gjendjes së tij të vështirë ekonomike dhe sëmundjes së tij tumoriale dhe për këtë arsye, edhe pse nuk ka qenë përfitues i ndihmës ekonomike, ai është ndihmuar me mënyra të tjera. Kështu, ai ka qenë përfitues i ndihmës prej 5000 lekë në fund të vitit 2021, si dhe ka qenë përfitues i ndihmave të tjera me karakter financiar.

Përfaqësuesja e Shërbimit Social Shtetëror u shpreh gjithashtu se kishin marrë dijeni nga ana e KMD-së lidhur me problematikën e parashtuar nga ankuesi. Ajo sqaroi se sistemi i ndihmës ekonomike nuk e ka përzgjedhur ankuesin si përfitues të kësaj ndihme, por pavarësisht kësaj nuk ka asnjë diskriminim të tij nga ana e institucioneve që ndodhen në cilësinë e subjekteve kundër së cilave drejtohet ankesa. Sistemi ka disa kriteret dhe kryen përzgjedhje si të individëve të vetëm, ashtu edhe të familjeve me shumë anëtarë. Por pavarësisht se ankuesi nuk është përzgjedhur nga sistemi për të përfituar ndihmë ekonomike, përsëri ka patur alternativa të tjera nëpërmjet së cilave ai është ndihmuar financiarisht. Përfaqësuesja e SHSSH theksoi faktin se sistemi i kushton më tepër vëmendje familjeve me fëmijë. Lidhur me çështjen se përse ankuesi rezulton përfitues i ndihmës ekonomike, ndërkohë që nuk e përfiton atë, ajo u shpreh se nuk ka dijeni mbi një fakt të tillë, pasi

në sistemin e tyre ai nuk rezulton përfitues. Por, për të marrë informacion mbi një çështje të tillë, Shërbimi Social Shtetëror i është drejtuar AKSH-it, të cilit i është drejtuar me shkresë zyrtare dhe është në pritje të një përgjigjeje, të cilën do t'ia dërgoje në vijim edhe KMD-së.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD iu drejtua Njesisë Administrative Topojë me shkresën nr. 106 prot., datë 14.01.2022, ku i kërkon informacion në lidhje me të gjitha ndihmat financiare të përfituara nga ankuesi nga viti 2019 e në vijim, duke kryer detajim të tyre, sipas kategorisë dhe periudhave kohore respektive.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Njësia Administrative Topojë dërgoi shkresën nr. 32/1 prot., datë 19.01.2022, nëpërmjet së cilës informon se z. A.N. është anëtar i familjes bujqësore dhe në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën bujqësore”, i ndryshuar, ka përfituar 5000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore në fshatin Seman i Ri.

Në datën 08.10.2019 ka aplikuar për ndihmë ekonomike pranë njesisë administrative Topojë dhe nuk ka përfituar pikët e mjaftueshme. Në vijim, ka aplikuar në datën 01.09.2020 dhe datën 05.11.2020 dhe në datën 03.11.2021 dhe përsëri nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për të përfituar ndihmë ekonomike. Në çdo aplikim në sistem, administratori e ka deklaruar ankuesin në gjendje shumë të varfër.

Në tetor të vitit 2020 është trajtuar me 16.000 lekë nga shteti, mbi bazën e paketës së ndihmës financiare në kushtet e pandemisë për familjet në nevojë. Gjatë muajve tetor –nëntor 2020, në njësinë Administrative Topojë u zbatua Projekti “Para për punë publike”, ku z. A.N. kërkoi të punonte. Kërkesa e tij u pranua nga njësia administrative, por në vijim, ai refuzoi të punonte për këtë projekt.

Njësia Administrative Topojë, duke parë gjendjen e tij ekonomike, i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Fier, e cila e kaloi për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Fier, skemën e ndihmës financiare 6%. Këshilli Bashkiak e miratoi kërkesën e Njesisë Administrative Topojë, duke i akorduar ankuesit ndihmën prej 1800 lekë për muajin nëntor e në vijim.

Në muajin dhjetor 2021, ankuesi ka përfituar shumën 5000 lekë nga Bashkia Fier si familje e varfër dhe 3000 lekë nga skema e ndihmës 6%. Njëkohësisht, Njësia Administrative Topojë thekson faktin se me rastin e festave të fundvitit 2015 e deri në vitin 2021, si dhe në periudhën e pandemisë Covid-19, ankuesi është trajtuar me ndihma ushqimore nga ana e Bashkisë Fier.

- Nëpërmjet shkresës nr. 117 prot., datë 17.01.2022, KMD iu drejtua zyrtarisht Qendrës Shëndetësore Topojë, nëpërmjet së cilës i kërkoi të kryeshin verifikimet përkatëse, se cila është baza e të dhënave, e përdorur nga kjo QSH, ku ankuesi rezulton si përfitues i



ndihmës ekonomike, pa qenë i tillë. Njëkohësisht, KMD kërkoi informacion se nga cili institucion administrohej kjo bazë të dhënash.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Qendra Shëndetësore Topojë dërgoi shkresën nr. 14 prot., datë 20.01.2022, ku sqaron se në regjistrin elektronik të pacientëve, ankuesi rezulton përfitues i ndihmës ekonomike dhe një të dhënë të tillë e merr automatikisht gjatë përditësimit që i bëhet regjistrit elektronik. Një fakt i tillë nuk shënohet nga mjeku i familjes, por ka mbetur gabimisht i shënuar nga institucione të tjera. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, Qendra Shëndetësore Topojë ka dërguar një foto të regjistrit elektronik, ku aktualisht z. A.N., i cili figuron pa Kartë Shëndeti, pasi i ka përfunduar afati i kartës paraardhëse.
- Në vijim, në datën 04.03.2022, KMD iu drejtua nëpërmjet e-mailit zyrtar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror<sup>5</sup>, ku i kërkoi të administronte kopje të shkresës së këtij institucioni drejtuar AKSH-it dhe shkresës përgjigje të AKSH-it, ku jepen shpjegime mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi, që dilte përfitues i ndihmës ekonomike pa qenë asnjëherë i tillë. Informacioni u kërkua që të dërgohej me e-mail brenda datës 09.03.2022.
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror nuk i ktheu përgjigje e-mailit të sipërcituar të KMD-së;
- Në këto kushte, KMD iu drejtuar sërisht institucionit të sipërcituar<sup>6</sup> nëpërmjet e-mailit zyrtar duke i bërë kujtesë për kthim përgjigje, si dhe për të dërguar kopje të korrespondencës me AKSH-in.

Në përgjigje të e-mailit të KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgoi e-mailin e datës 15.03.2022, ku citohet: *“Referuar seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 11.01.2022, për shqyrtimin e ankesës së z. A.N., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile” dhe “gjendjes shëndetësore”, ju informojmë se: “Lidhur me faktin se përse ankuesi rezulton në kartën e tij të shëndetit si përfitues i ndihmës ekonomike, pa qenë i tillë, më datën 10.01.2022 nga ana jonë i është dërguar e-mail Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI-it) për verifikimin e rastit si institucion*

---

<sup>5</sup> E-maili iu drejtua znj. D.M., përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së;

<sup>6</sup> E-maili iu drejtua znj. D.M., përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, si dhe në e-mailin zyrtar të institucionit [info@sherbimisocial.gov.al](mailto:info@sherbimisocial.gov.al);

*përgjegjës për administrimin e sistemeve elektronike. Nga ana e AKSHI-it ende nuk kemi përgjigje për rastin në fjalë. Bashkëlidhur gjeni e-mailin dërguar AKSHI-t.”*

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

Neni 7 i këtij ligji parashikon shprehimisht se:

*“Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:*

- a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;*
- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;*
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;*
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në castin e punësimit të tyre;*
- d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.”*

Neni 12, pikat 1-2, të ligjit të sipërcituar parashikojnë gjithashtu se ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Ndhma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndhmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

Kategoritë e individëve që mund të aplikojnë për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe mënyrën se si bëhet pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike, përcaktohet shprehimisht në nenin 16, pikat 1-3, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se:

*1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:*

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në Vendimin nr. 956, datë 7.12.2016, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike” parashikohet se formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoaria, trashëgimia dhe dhuratat. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë kontekst, është pikërisht sistemi zbatues i kësaj formule, që përzgjedh familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Kreu I, pika 2, germa a), e VKM-së sipërcituar, përcakton se: “...përfituesit e ndihmës ekonomike janë...(a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.”

Ndër të tjera, në këtë VKM, në Pjesën II përcaktohet edhe procedura e aplikimit për ndihmë ekonomike. Gjatë kësaj procedure, theksohet roli tepër i rëndësishëm i administratorit shoqëror. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat

e mëposhtme: a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për: i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; ii) llojin e banesës; iii) pasuritë/asetet familjare; iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera. Njëkohësisht, administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

Në pikën 8, të Pjesës II, të VKM-së së sipërcituar parashikohen edhe funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike. Kështu, kjo strukturë ka përgjegjësitë e mëposhtme: a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar, si dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë; b) merr vendime për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzon kërkesën për dhënien e përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit, sipas formatit në shtojcën 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi; c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë për të njoftuar kërkesit për përfitimin e ndihmës ekonomike ose për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike. Procesi i vendimmarrjes kryhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike. Referuar gërmes b), të pikës 8, të kësaj VKM-je, duhet vënë në dukje fakti se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr vendime në bazë të rezultateve të dala nga sistemi elektronik i pikëzimit, si dhe përcakton masën e përfitimit apo refuzimit të kërkesës së familjeve aplikuese në bazë të parashikimeve ligjore.

Për sa më sipër, ankuesi A.N. ka aplikuar 4 (katër) herë për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike dhe në të katër aplikimet e tij, sistemi elektronik nuk e ka përzgjedhur si përfitues të kësaj ndihme. Z. A.N. ka aplikuar për ndihmë ekonomike pranë Njesisë Administrative Topojë në datën 08.10.2019, në datën 01.09.2020, datën 05.11.2020 dhe në datën 03.11.2021 dhe në të gjitha rastet nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për të përfituar ndihmë ekonomike.

Nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara refuzimi i ankuesit për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike është kryer nga sistemi përkatës i pikëzimit, i cili e bën përzgjedhjen në mënyrë automatike të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Kriteret dhe vlerësimin përkatës e bën sistemi dhe në asnjë rast subjektet kundër së cilave drejtohet ankesa.

Në këtë kontekst, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier nuk kanë ndikuar në refuzimin e ankuesit si përfitues nga ana e sistemit të pikëzimit.

Pavarësisht sa më sipër, ligjvënësi ka përcaktuar mënyra alternative për të ndihmuar ato familje që nuk rezultojnë përfituese të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit, duke i trajtuar me me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Kështu në Pjesën IV, të Vendimit nr. 597/2019, të Këshillit të Ministrave, Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike është 6 për qind e këtij fondi dhe mbi këtë fond mund të shtohen ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Akordimi i fondit deri në 6 për qind i shtohet çeljes faktike të çdo 2-mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Familjet në nevojë, në momentin që përzgjidhen nga lista e familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrisë Elektronike Kombëtare për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.

Në kushtet kur, ankuesi është refuzuar disa herë nga sistemi elektronik i pikëzimit për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike, si dhe duke qenë në dijeni të gjendjes së tij ekonomike, Njësia Administrative Topojë i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Fier, e cila ka kaluar për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Fier, skemën e ndihmës financiare 6%. Këshilli Bashkiak e miratoi kërkesën e Njesisë Administrative Topojë, duke i akorduar ankuesit ndihmën prej 1800 lekë për muajin nëntor 2021 e në vijim.

Përveç sa më sipër, ankuesi ka përfituar në muajin tetor 2020, edhe paketën e ndihmës financiare prej 16 000 lekësh të akorduar, për familjet në nevojë në kushtet e pandemisë Covid-19, në bazë të parashikimeve të Vendimit nr. 13, datë 22.04.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 305, datë 16.04.2020, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”*. Kështu, në pikën 1, të këtij Vendimi parashikohet: *“Dhënia e ndihmës financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar*

*bashkive, përveç rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 15 të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Në muajin dhjetor 2021, ankuesi ka përfituar shumën 5000 lekë nga Bashkia Fier si familje e varfër dhe 3000 lekë nga skema e ndihmës 6%. Njëkohësisht, Njësia Administrative Topojë e ka ndihmuar ankuesin përgjatë viteve 2015 -2021, si dhe gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, me ndihma ushqimore.

Komisioneri gjykon se në kushtet kur, ankuesi A.N. vuan nga Tumor Testi, ai duhet të marrë në konsideratë mundësinë e aplikimit për përfitim nga skema e aftësisë së kufizuar (KEMP), e cila është një procedurë e ndarë nga ndihma ekonomike dhe kryhet sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin nr. 182, datë 26.02.2020, e Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës socialë"*, të ndryshuar.

- Ankuesi rezulton në regjistrin elektronik të pacientëve të administruar nga Qendra Shëndetësore Topojë, si përfitues i ndihmës ekonomike, fakt që është reflektuar edhe në kartën e tij të shëndetit, ndërkohë që ai nuk është i tillë.

Në bazë të Vërtetimit nr. 132 prot., datë 21.09.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Fier rezulton se z. Aristir Lili A.N., banor i Njesisë Administrative Topojë nuk është trajtuar me ndihmë ekonomike (përkrahje sociale) dhe nuk trajtohet aktualisht nga Drejtoria e Shërbimit Social. Në këtë vërtetim sqarohet fakti se ankuesi ka aplikuar në sistem për here të fundit në muajin Nëntor 2020, por nuk është shpallur fitues dhe nuk përfiton ndihmë ekonomike. I njëjti fakt përforcohet me shkresën nr. 9316 prot., datë 08.10.2021, të së njëjtës strukture, ku theksohet fakti se ankuesi nuk ka përfituar asnjëherë ndihmë ekonomike.

Gjatë hetimit administrativ të ankesës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Fier kanë sqaruar se në sistemin e tyre, z. A.N. nuk rezulton përfitues i ndihmës ekonomike, pasi asnjëherë nuk ka qenë i tillë. Ndërkohë që referuar e-mailit të dërguar nga Shërbimi Social Shtetëror në adresë të KMD-së rezulton se AKSHI, i cili është institucioni përgjegjës për administrimin e sistemeve elektronike nuk është shprehur për rastin e z. A.N..

Në këto kushte, kur në sistemin elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier, Z. A.N. nuk rezulton përfitues i ndihmës ekonomike, si dhe Qendra Shëndetësore Topojë ka sqaruar se sistemi i saj elektronik mbi pacientët, mbi bazën e së cilit lëshohet karta e shëndetit, përditësohet nga sisteme të tjera të dhënash, (për të cilat kjo qendër nuk ka informacion të mëtejshëm), Komisioneri gjykon kemi të bëjmë më një gabim të karakterit teknik lidhur me shënimin e të dhënave të z. A.N..



Në këto kushte, sugjerojmë që z. A.N. duhet t'i drejtohet AKSHI-t për verifikimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se lidhur me çështjen e akordimit të ndihmës ekonomike, e cila është objekt i ankesës së tij, ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të "*gjendjes ekonomike*", "*gjendjes civile*" dhe "*gjendjes shëndetësore*" të z. A.N., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Të mira e shërbime  
Shkak – gjendja ekonomike, gjendja shëndetësore, gjendja civile  
Lloji i vendimit - mosdiskriminim